



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 14211 Prot.
2

Tiranë, më 26.05 2023

V E N D I M

Nr. 55 dt. 26.05. 2023

**“MIRATIMIN PARAPRAK TË PAGAVE TË STAFIT AKADEMIK TË
UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS, SIPAS VKM NR. 243 DATË
20.04.2023 “PËR DISA NDRYSHIME NË VKM NR.748, DATË 11.06.2009 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE” PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHTESA MBI
PAGË TË PERSONELIT AKADEMIK TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË
ARSIMIT TË LARTË”**

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, neni 38 germa “h” në”; në Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar; në Ligjin nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”; në VKM nr. 75 datë 12.02.2018 “Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë”, i ndryshuar pika 7; në Udhëzimin e Përbashkët të MAS dhe MFE nr. 20 datë 20.09.2019, “Për skemën e financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”; në VKM nr. 243 datë 20.04.2023 “Për disa ndryshime në VKM nr.748, datë 11.06.2009 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të personelit akademik të institucioneve publike të Arsimit të Lartë”; në shkresën nr. 1416 datë 24.05.2023 të Administratorit; në Vendimin e Rektoratit nr. 47 datë 23.05.2023, Senati Akademik i UST-së në mbledhjen e datës 26.05.2023,

VENDOSI:

1. Miratimin paraprak të pagave të personelit akademik të Universitetit të Sporteve të Tiranës në kufirin maksimal të tyre sipas në lidhjes nr. 1 “Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e personelit akademik, në IPAL”, të Vendimit nr. 243, datë 20.04.2023 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 748, datë 11.06.2009 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të personelit akademik të institucioneve publike të Arsimit të Lartë”, të ndryshuar.
2. Efektet financiare për çdo nivel page mbi kufirin minimal (kolona 2), deri në kufirin maksimal (kolona 3) të përcaktuar në lidhjen nr.1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave të referuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohen nga të ardhurat e Universitetit të Sporteve të Tiranës dhe i shtrin efektet financiare nga data 01.04.2023.

3. Ky vendim i përcillet Bordit të Administrimit për miratim në përputhje me nenin 49, pika 1 gërma “ç” të Ligjit nr. 80/2015.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT

Prof.Dr.Agron KASA

